



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:082528  
Datë: 13.02.2024  
Numri i dokumentit: 05319206

AC. nr. 7705/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit M. S. nga Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson av. H. I., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Departamenti i Shpronësimit, të cilin me autorizim e përfaqëson N. A., për shkak të pagimit të kamatës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1161/2020 datë 24.08.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 07.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Departamenti i Shpronësimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1161/2020 datë 24.08.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin C.nr.1161/2020 datë 24.08.2021, ka vendosur: I.APROVOHET në tërësi, padia dhe kërkespadia e paditësit M. S. nga Ferizaj, e ushtruar kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Departamenti i Shpronësimit, si e bazuar. II. DETYROHET e padituria, Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Departamenti i Shpronësimit, që paditësit M. S. nga Ferizaj, t’ua paguaj shumën prej 18.087,42 € (tetëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e shtatë euro e katërdhjetë e dy cent), në emër të interesit ligjor – kamatëvonesës së pa paguar për pronën e shpronësuar, me interes vjetor prej 7 % prej ditës së paraqitjes së padisë e deri në

pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1294 euro, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar duke e refuzuar ë tërësi si të pa bazuar kërkesë padinë e paditësit, apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi, edhe pse i njëjti me kohë është njoftuar me ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi M. S. nga Ferizaj, me datë 02.05.2017, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Departamenti i Shpronësimit, për shkak të kompensimit të kamatës, kërkesë kjo e precizuar si në shqyrtimin kryesorë të datës 14.07.2021.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, deklarimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin, C.nr.372/2017 i datës 05.10.2018, me të cilin ka vendosur që të: Aprovohet në tërësi padia dhe kërkesë padia e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit të palës paditëse për plotësimin e aktgjykimin, ka marrë aktgjykim C.nr. 372/2017 të datës 09.01.2019, duke e aprovuar pjesërisht propozimin e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër aktgjykimin C.nr.372/2017 i datës 05.10.2018, ankesë ka parashtruar paditësi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e paditësit dhe të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar në pikën II dhe të detyrohet e paditura që paditësit ti kompensoj shpenzimet e procedurës, apo të njëjtin ta prishë dhe çështjen ta kthej në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjithashtu, kundër këtyre aktgjykimeve, e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar duke e refuzuar ë tërësi si të pa bazuar

kërkesë padinë e paditësit, apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendim AC.nr. 474/2019 të datës 22.06.2020, ka aprovuar si të bazuara ankesat e paditësit dhe të paditurës, ndërsa aktgjykimin C.nr. 372/2017 të datës 05.10.2019 si dhe C.nr. 372/2017 të datës 09.01.2019, janë anuluar dhe çështja është kthyer në ri gjykim dhe ri vendosje.

Gjykata e shkallës së parë, në ri vendosje, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, deklarimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin, C.nr.1161/2020 i datës 24.08.2021, me të cilin ka vendosur që të: Aprovohet në tërësi padia dhe kërkesë padia e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i gjendjes së fakteve dhe provave të çështjes, gjithë këtë në kontekstin e parashtrimeve të palëve ka konstatuar këtë gjendje faktike me vendimin e qeverisë nr.10/73, të datës 05.02.2016, dhe me tabelat për pronat e shpronësuar, e paditura ka marrë vendimin për shpronësimin e pronës së paluajtshme të paditësit nr.700.9, ZK. Bibaj, me dt. 02.12.2015, dhe 128-5, ZK. Fshati Vjetër, me dt. 11.12.2015, ku si kundërvlerë për pronat e shpronësuar në sipërfaqe të përgjithshme prej 9366m<sup>2</sup>, ku ia ka caktuar shumën prej 221.392.00€ , ndërsa me njoftimin e pagesës në historiatin e llogarisë bankare të paditësit, gjykata ka konstatuar se me datë 05.04.2017, e paditura ia ka paguar paditësit në tërësi çmimin e shpronësimit, çka do të thotë, se nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të shpronësimit e deri në pagesën e kundërvlerës së shpronësimit, kanë kaluar një vit e dy muaj.

Më tej ka theksuar se: Gjykata ka gjetur se sipas Ligjit nr. 03/L205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme neni 16 par. 2 parasheh që kompensimi i kërkuar në Vendimin Përfundimtar do të jetë, (2.1) *shuma e përcaktuar në aktin përkatës të vlerësimit plus (2.2) interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit përfundimtar e deri në datë të pagesës, ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë për qind interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore*. Në këtë rast gjykata ka konstatuar se e paditura, ia ka paguar paditësit vlerën e shpronësimit me vonesë dhe atë pas një viti e dy muaj nga hyrja në fuqi e vendimit për shpronësim, andaj, duke u referuar nenit të sipërshënuar, neni 16 par.2, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit për shumën e përcaktuar nga ekspertiza e ekspertit financiar prej 18.087.42€, në emër të kamatës për periudhën prej 05.02.2016 deri me date 05.04.2017, është tërësisht i bazuar, si për nga baza juridike ashtu edhe për nga lartësia e saj.

Më tej ka arsyetuar se: Lidhur me llogaritjen e shumës gjegjësisht lartësisë së kërkesëpadiës së paditësit, gjykata ka caktuar ekspertin financiar për llogaritjen e shumës së kamatëvonesës duke e shumëzuar të njëjtin me 7% të kamatëvonesës ligjorë për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të vendimit nga data 05.02.2016, me date 05.04.2017, dhe del se shuma për pagesë të kamatëvonesës është në lartësi prej 18.087.42€, e cila përkon me shumën e pretenduar në padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit të rregulluar në seancën gjyqësore.

Më tej ka theksuar se: Pretendimet e palës së paditur se pagesa është kryer brenda afatit prej 2 vitesh të paraparë me pikën 7, të Vendimit të Qeverisë nr.10/73, të datës 05.02.2016, i cili afat është paraparë po ashtu me nenin 16 par. 6, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr.03/L-139, për gjykatën ky pretendim është i pa bazuar, në nenin 16 paragrafi 6, thekson se nëse nuk paguhet brenda 2 vitesh kundërvlera e shpronësimit, atëherë pala e shpronësuar mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për të kërkuar nxjerrjen e një urdhëri për revokimin ose anulimin e këtij vendimi, pra dallimi në mes të paragrafit 6 dhe paragrafit 2 të nenit 16, është se te paragrafi 6, mund të kërkohej anulimi i tërësishëm i vendimit të shpronësimit ndërsa te paragrafi 2, i këtij neni parashihet që kamatëvonesa fillon të rrjedhë nga dita e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar, e deri në pagesën definitive të kundërvlerës së shpronësimit. Pra paragrafi 2, është dispozitë specifike e cila në këtë rast e derogon dispozitën gjenerale paragrafin 6, të nenit të njëjtë, për më të për nga se aty në pikën 2.2, parashihet që “interesi në atë shumë që është akumuluar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar, deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej 7%, interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore”, e që edhe nga llogaria bankare e paditësit që nuk është kundërshtuar as nga e paditura, shihet se paditësit i është kompensuar vetëm shumë e përcaktuar me aktvlerësim që ishte 221.392.00€, por pa e llogaritur interesin në këtë shumë siç parashihet në pikën 2.2 të par.2 të nenit 16 të këtij ligji.

Vendimi për kamatën ligjore është marrë në kuptim të nenit 16 par 2 pika,1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-205 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës është marrë në kuptim nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për aprovimin e kërkesë padisë së paditësit e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit si të bazuar, pasi që edhe gjykatës së Apelit i rezultoi e njëjta gjendje faktike e vërtetuar sepse në këtë rast, në mesë palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi, sipas vendimit përfundimtar të të paditurës, nr.10/73, të datës 05.02.2016, dhe me tabelat për pronat e shpronësuar e gjithashtu në bazë të akt vlerësimit, e paditura ka marrë vendimin për shpronësimin e pronës së paluajtshme të paditësit nr.700.9, ZK. Bibaj, me dt. 02.12.2015, dhe 128-5, ZK . Fshati Vjetër, me dt. 11.12.2015, ku si kundërvlerë për pronat e shpronësuar në sipërfaqe të përgjithshme prej 9366m<sup>2</sup>, ku ia ka caktuar shumën prej 221.392.00€, i cili çmim është paguar me datë 05.04.2017, çka do të thotë, se nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të shpronësimit e deri në pagesën e kundërvlerës së shpronësimit, kanë kaluar një vit e dy muaj, fakte këto të vërtetuara edhe nga provat që gjinden në shkresat e lëndës. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë, me provat e administruara me mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar edhe lartësinë e kërkesë padisë së paditësit, pasi që të njëjtën e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës financiare të ekspertit A. K., ekonomist i diplomuar, e datës 03.06.2021, i cili ka konstatuar se kamatë vonesa e akumuluar që nga hyrja në fuqi e vendimit përfundimtar datë 05.02.2016 e deri më 05.04.2017, ka arritur shumën prej 18,087.42 euro, të cilës ekspertizë ja fali besimin e plotë pasi që e njëjta ishte përpiluar në mënyrë shkencore dhe në përputhje me të gjitha provat që gjinden në shkresat e lëndës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se: Me nenin 16 paragraf 2, pika 2.2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, përcaktohet se: “ Organi Shpronësues ia paguan, ose kërkon nga parashtruesi i kërkesës ose Përfituesi i prituri - nëse ka të këtillë - që t’ua paguajë shumën e kompensimit të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar, Pronarit të prekur ose Zotëruesit të Interesit. Kompensimi i kërkuar në Vendimin Përfundimtar do të jetë: “ interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë për qind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore “. Andaj, duke qenë se vendimi përfundimtar i të paditurës, me nr. 10/73 i datës 05.02.2016, ka hyrë në fuqi në ditën e shpalljes në gazetën zyrtare dhe atë me datë 05.02.2016, pjesë përbërëse e të cilit vendim kanë qenë edhe akt vlerësimet e datës 02.12.2015 dhe datës 11.12.2015, nga të cilët është përcaktuar shuma prej 221.392.00€, për kompensim të paluajshmërisë së shpronësuar në procedurë të shpronësimit, të cilën shumë e paditura ka qenë e obliguar ti paguan paditësit që nga hyrja në fuqi e vendimit përfundimtar, por një gjë e tillë nuk është respektuar nga e paditura dhe e njëjta është në detyrim për pagesën e kamatës.

Gjykatës së Apelit i rezultuar të pa bazuara pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me atë se sipas vendimit përfundimtar Organi Shpronësues ka qenë i obliguar të bëjë pagesën në afat prej 2 viteve, nga hyrja në fuqi e vendimit përfundimtar, por të njëjtët pretendime gjykata e Apelit nuk i mori për bazë, pasi që në pikën 7 është përcaktuar që “*brenda dy viteve nga hyrja në fuqi të vendimit, Departamenti i shpronësimit në Kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit*”, por kjo nuk e ka ndaluar të paditurës që të bëjë pagesën e detyrimit në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit e gjithashtu e njëjta nuk ka dhënë asnjë arsye apo nuk ka ofruar asnjë provë për ti arsyetuar pretendimet e vonesave të pagesës dhe arsyetimi i të paditurës se ne kishim kohë të pagesës në afat prej dy (2) viteve, ka të bëjë me të drejtën e personit që kishte për të pranuar kompensimin

me qëllim që pas këtij afati, nëse i njëjti nuk pranon kompensimin ti drejtohet Gjykatës me ankesë të përcaktuar me nenin 16 par. 6 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i cili parasheh që “Shuma e kompensimit të shpronësimin e përcaktuar në Vendimin Përfundimtar paguhet plotësisht brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit. Nëse kompensimi nuk paguhet brenda kësaj kohe, Personi i cili është dashur të pranojë kompensimin mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për të kërkuar nxjerrjen e një urdhri për revokimin ose anulimin e këtij vendimi” dhe nuk ka të bëjë fare me pagesën e interesit. Andaj, duke qenë se e njëjta nuk ka paguar detyrimin me hyrjen në fuqi të vendimit pa ndonjë arsye, paditësit i lindë e drejta në bazë të nenit 16 paragraf 2, pika 2.2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, që të kërkoj kamatë vonesën, ashtu siç është vendosur me aktgjykimin e ankimuar.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, për gjykatën e Apelit është i drejtë dhe i cili bazohet në dispozitat e nenit 379 par.4 të LMD-së, i cili parasheh që “ Në shumën e papaguar të kamatës mund të kërkohej kamatëvonesa vetëm nga dita kur gjykatës i është paraqitur kërkesa për pagimin e saj”. Andaj, me qenë se e paditura është vonuar në pagesën e kamatës, gjykata e shkallë së parë me të drejtë ka vendosur si në pikën II. të aktgjykimit të ankimuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPJ-së si dhe në përputhje.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.C.nr.7705/2021 datë 07.02.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj, d.v